

PROCESVERBAL
nga seanca e 12-të e Këshillit të Agjencisë
për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale
e mbajtur më 28.03.2022

Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr.Metodija Jançeski.

Anëtarë që mungojnë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr.Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishëm të tjerë: /

Z.Petrushevski e hapi seancën e 12-të të Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në ambjentet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë, njëzëri miratoi si në vijim:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, e mbajtur më 18.03.2022.
2. Propozim-raporti vjetor i punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2021.
3. Propozim për përcaktimin e qëndrimit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në lidhje me rezultatin e revizionit të kryer nga revizori i pavarur për vitin 2021.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shikoj dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin nga seanca e 11-të e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, e mbajtur më 18.03.2022, me teks siç ishte propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozim-raportin vjetor për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2021. Shpjegoi se dokumenti i propozuar i cili është në formën përfundimtare nuk ka dallim nga draft-versioni që paraprakisht ishte miratuar, është identike me atë të mëparshmen përveç se janë korrigjuar gabimet e mundshme teknike.

Z.Petrushevski tha se qëndrimi i tij në lidhje me Raportin nuk ka ndryshuar nga hera e mëparshme, dmth përsëri e mbështet raportin në këtë formë siç është propozuar ndërsa diskutimin që e tha herën e kaluar mbetet i shënuar në procesverbalin që u miratua në seancën e sotme.

Këshilli i Agjencisë njëzëri solli Vendim me të cilin u miratua Raporti vjetor për punën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2021 (me Raportin për realizim të Planit vjetor për mbikëqyrjen programore për vitin 2021 dhe Raportin financiar për realizim të Planit financiar për vitin 2021 dhe llogarin vjetore me të ardhurat e realizuara, shpenzimet, kërkesat dhe detyrimet për vitin 2021), si teks i propozuar.

Spektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta shpalli në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 3

Z Trajçevski e arsyetoi Propozimin për përcaktimin e banesës së Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në lidhje me rezultatin nga revizioni i kryer nga revizori i pavarur për vitin 2021. Sqaroi se në bazë të Raportit të revizorit i dorëzuar në materialet e seancës u propozua të miratohet qëndrimi i Këshillit se pajtohet plotësisht me konkluzionet dhe rekomandimet e bëra nga revizori i pavarur.

Këshilli i Agjencisë njëzëri e miratoi qëndrimin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në lidhje me rezultatet nga revizioni i kryer nga revizori i pavarur për vitin 2021.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale plotësisht pajtohet me mendimin e dhënë në Raportin e revizionit për vitin 2021, i vërtetuar në arkivin e Agjencisë me numër 03-1117/2 nga viti 22.03.2022.

Spektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, qëndrimin e mësipërm ta shpalli në ueb faqen e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur asnjë diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-1198/4
31..03.2022
Sh k u p

Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuale
Kryetar i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI d.v